	PËRSHKRIMI I VENDIT TË PUNËS		F-009-5.1
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 1 nga 2

Përshkrimi i vendit të punës

Data e hyrjes në fuqi: 25.10.2023

Pozita:

PRAKTIKANT/E- Zyrtar/e i/e projekteve

Përmbledhje

Praktikanti është përgjegjës për të kryer detyra në realizimin e aktiviteteve të projekteve të cilat menaxhohen nga Qendra për Arsim e Kosovës - KEC.

Kualifikimet


- Të jetë student i vitit të fundit në universitet ose i sapo diplomuar;
- Të ketë njohuri të aspekteve administrative dhe financiare të menaxhimit të projekteve;
- Të ketë njohuri të mira të të kuptuarit dhe të shkruarit e gjuhës shqipe dhe angleze;
- Të ketë njohuri të avancuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe pakove standarde softuerike, me qëllim të organizimit të punës.

Aftësitë tjera

- Aftësi të mira organizative;
- Aftësi të mira të komunikimit;
- Aftësi për të punuar me të dhëna sasiore dhe cilësore.

Detyrat

- Nën drejtimin e menaxherit përgjegjës ose zyrtarit të projektit:
 - Të ndihmojë në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve ditore të projekteve;
 - Të ndihmojë në përgatitjen e takimeve të zyrës, ngjarjeve të ndryshme të projekteve, përfshirë dërgimin e ftesave dhe mbajtjen e procesverbaleve gjatë takimeve;
 - Të mbështesë procesin e arkivimit të dokumenteve të projekteve për të cilat është i angazhuar;
 - Të ndihmojë procesin e komunikimit me partnerët, bashkëpunëtorët dhe përfituesit e projekteve;
 - Të ndihmojë zyrtarin e projektit/menaxherin e projektit në iniciimin e blerjeve të mallrave dhe shërbimeve për nevojat e projekteve;

	PËRSHKRIMI I VENDIT TË PUNËS		F-009-5.1
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 2 nga 2

- Të zhvillojë marrëdhënie të mira me të gjithë stafin e KEC dhe palët tjera të lidhura me projektin.

Lidhjet dhe raportimet

Praktikanti raporton tek Menaxheri i Projektit.

Orët e punës

Praktikanti ka orar të plotë të punës prej 8 orëve në organizatë. Sipas nevojës, ofrohen lehtësime për ndjekjen e ligjëratave, provimeve, ndjekjen e trajnimeve dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me ngritjen profesionale.

Kompensimi

Kompensimi i praktikantit bëhet konform kontratës së punës dhe mund të ndryshohet apo të modifikohet varësisht prej rezultateve të vlerësimit të performancës.

Versioni	Përshkrim i ndryshimit	Data
1.0	Publikimi fillestar	27.12.2016
2.0	Publikimi i dytë	25.10.2023